



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

SHËNIM ZYRTAR NR.29/2017

Nga takimi i Komisionit me z.Janez Kopaç, drejtor i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë

Më 24.1.2017, ora 14:30, Prishtinë

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i kryesuar nga **Muhamet Mustafa**, priti sot në takim, z.**Janez Kopaç**, drejtor i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë me seli në Vjenë dhe bashkëpunëtorët e tij, me të cilët diskutuan në lidhje me reformat mbi komunitetin e energjisë dhe sfidat e Kosovës në fushën e energjisë.

Drejtori i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Kopaç, i informoi anëtarët e komisionit me obligimet e këtij sekretariati, përkitazi me monitorimin e zbatimit të legjislacionit dhe paraqitjen e raportit në Këshillin Ministror të Komunitetit të Energjisë. Ai prezantoi pjesën e raportit kushtuar Kosovës, duke përfshirë energjinë elektrike, gazin, autoritetin rregullator, mjedisin, energjinë e ripërtëritshme, naftën, eficiencën e energjisë, konkurrencën dhe statistikën.

Kopaç theksoi nevojën e miratimit të legjislacionit sekondar në pajtim me ligjet përkatëse, si dhe liberalizimin e çmimeve në tregjet me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike.

Ne fund të prezantimit, z.Kopaç përmendi sfidat e Komunitetit të Energjisë në vitin 2017 si: projektet në interes të Komunitetit të Energjisë, zgjerimin e kufijve për palë të reja, legjislacionin për mjedisin, shkollën verore të Komunitetit të Energjisë, qendra për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe ndërmjetësimin, vlerësimin e rregullatorëve dhe iniciativat regjionale.

Ai, po ashtu, njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me takimin e Plenumit të Komunitetit të Energjisë, më 28 mars, në Bruksel ku Kosova e ka presidencën.

Kryetari i Komisionit, **Muhamet Mustafa**, e falënderoi z. Janez Kopaç për angazhimin e Sekretariatit dhe për mbështetjen e madhe që i ka dhënë dhe po i jep Kosovës në fushën e energjisë, si dhe për gatishmërinë e tij për ta mbajtur të njoftuar komisionin me zhvillimet në komunitetin evropian të energjisë. Ai tha se Kosova ka miratuar pakon ligjore në këtë fushë, ndërsa është e angazhuar edhe në përgatitjen e legjislacionit sekondar.

Mustafa bëri të ditur se pritet të vijë strategjia e re e energjisë, ku do të trajtohet sidomos efienca e energjisë, burimet e ripërtërishme, gazi dhe energjia elektrike. Problemet në linjën e interkoneksionit 400 KV me Shqipërinë, Mustafa i konsideroi politike, ndërsa theksoi nevojën e zgjidhjes sa më të shpejtë të tyre.

Për pengesat e Serbisë në sektorin energjetik të Kosovës, foli edhe anëtari tjetër i këtij komisioni, **Besim Beqaj**. Ai theksoi se një nga çështjet kryesore që duhet të diskutohet në Këshillin Ministror është funksionalizimi i interkoneksionit, dhe ne duhet të kemi një sistem të integruar me Shqipërinë.

Beqaj kërkoi angazhim më të madh të Sekretariatit për zgjidhjen e problemeve në bazë të fakteve të cilat qëndrojnë.

Në anën tjetër, z.Kopac veçoi veprimet e ndërmarra nga Sekretariati, në funksion të zgjidhjes së këtyre problemeve.

Në fund, kryetari i Komisionit z. Muhamet Mustafa, potencoi se mbeten shumë çështje të cilat duhet zgjidhur dhe se e konsideroi të nevojshme edhe më tutje përkrahjen e Sekretariatit në qëndrueshmërinë e furnizimit të sigurt me energji elektrike dhe në sfidat për treg të hapur të energjisë elektrike.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.